REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 289/294/23
Datë/Datum. 05.07.2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEËE BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. Nr. 289/23
294/23

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Kimete Gashi – Kryetare vendosur sipas ankesës së (OE) "Infinitt" sh.p.k., dhe ankesën e OE "Europrint Group" sh.p.k, kundër vendimit për anulim të aktivitetit të prokurimit "Furnizim me material shpenzues për zyre-Ritender 3" me nr. të prokurimit:214-23-2825-1-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -Policia e Kosovës, më 05.07.2023, mori këtë:

V E N D I M

1. Aprovohen, si të bazuara ankesat e OE-ve "Infinitt" sh.p.k.,me nr. 2023/0289, e datës 19/05/2023, dhe ankesa e OE "Europrint Group" sh.p.k, me nr. 2023/0294, e datës 22/05/2023 kurse vendimi i AK Policia e Kosovës lidhur me aktivitetin e prokurimit "Furnizim me material shpenzues për zyre-Ritender 3" me nr. të prokurimit:214-23-2825-1-2-1anulohet, ndërkaq aktiviteti i prokurimit kthehet në Rivlerësim.

2. Në afat prej 10 ditësh, AK duhet ta informojë OSHP për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit, në të kundërtën, OSHP ka të drejtë të ndërmarrë masa ndaj AK për mos respektim të vendimit sikurse parashihet me dispozitat e nenit 131 të LPP.

3. Kthehen mjetet e deponuara në emër të taksës tarifore për parashtrimin e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Infinitt" sh.p.k dhe "Europrint Group" sh.p.k.n e ankesës në llogarinë e Operatorit Ekonomik "Infinitt" sh.p.k.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me datën 28.03.2023, AK Policia e Kosovës, ka publikuar njoftimin për kontratë, ndërsa hapja e ofertave është bërë me datë 13.04.2023. Me 04.05.2023, Policia e Kosovës në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues për anulim të aktivitetit të prokurimit me titull: "Furnizim me material shpenzues për Zyre-Ritender 3" me nr. të prokurimit:214-23-2825-1-2-1.

Me datë 10.05.2023, OE ankues "Infinitt" sh.p.k.,ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Policia e Kosovës me datë 11.05.2023, AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 04.05.2023.

Me datë 06.05.2023, OE ankues "Europrint Group" sh.p.k, ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim pran AK- Policia e Kosovës me datë 11.05.2023, AK e ka refuzuar si të pa bazuar kërkesën për rishqyrtim dhe e ka vërtetuar B58 Njoftimin mbi vendimin autoritetit kontraktues të datës 04.05.2023.

Me datën 19.05.2023 OE ankues "Infinitt" sh.p.k., ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 289/2023, kundër njoftimit mbi vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Me datën 22.05.2023 OE ankues "Europrint Group" sh.p.k, ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 294/2023, kundër njoftimit mbi vendimin për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Elementet qenësore të këtij aktiviteti të prokurimit konsistojnë si në vijim: Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës: furnizim, vlera e parashikuar e kontratës: 11,616.95€.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë GOE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

Raporti i ekspertizës i cituar si më sipër është pranuar nga gjitha palët. AK me datë 05.06.2023, ka deklaruar se nuk pajtohet me mendimin e ekspertit ndërsa Operatori

ekonomik "Infinitt" sh.p.k., ankues me datë 01.06.2023,është deklaruar se pajtohet me mendimin e ekspertit, ndërsa OE ankues "Europrint Group" sh.p.k. nuk është deklaruar.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 01.06.2023, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- ankesa e OE "Infinitt" sh.p.k. dhe OE "Europrint Group" sh.p.k, të aprovohen si të bazuara.

- të anulohet Njoftimi mbi Vendimin e AK-së i datës 04.05.2023 ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër shënuar të kthehet në rivlerësim.

Paneli Shqyrtues konsideroi se lidhur me çështjen në rastin konkret, nuk ka nevojë të konvokohet seanca dëgjimore me palë, konform nenit 24 paragrafi 1, i Rregullores së Punës së OSHP, përderisa pretendimet e palëve, provat, parashtresat e tyre dhe ekspertiza e ekspertit shqyrtues, ofrojnë të dhëna të mjaftueshme për të vendosur në aspektin meritor.

<u>Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Infinitt" sh.p.k.</u>

<u>Pretendimi 1:</u>

OE "Infinit" SH.P.K pretendon se AK/komisioni i vlerësimit gjatë vlerësimit të ofertave nuk ka vepruar në harmoni me LPP Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 përkatësisht dispozitat ligjore të lartcekura dhe Udhëzimin Operativ për Prokurim Publik. Me 04.05.2023. AK ka nxjerrë njoftimin mbi vendimin e autoritetit kontraktues ku ka vendosur të anulojë procedurën e prokurimit me arsyetimin se të gjithë OE ofertuar kanë ofruar çmime jo-normalisht të larta, ky konstatim i AK/komisionit vlerësues nuk qëndron. Oferta e kompanisë sonë është me e ulët se buxheti total i planifikuar nga autoriteti kontraktues për blerjen e këtyre produkteve prandaj nuk mund të cilësohet si ofertë me çmime jo-normalisht të larta.

Autoriteti kontraktues bie në kundërshtim me vetveten përkatësisht njësinë kërkuese të cilët kanë planifikuar buxhetin e paraparë për këtë aktivitet të prokurimit. Buxheti total i planifikuar nga AK për këtë aktivitet te prokurimit është 11,616.95 ndërsa oferta e kompanisë sonë ne total 10,958.50. Ky aktivitet i prokurimit është tenderuar 4 herë dhe AK çdoherë ka planifikuar te njëjtin buxhet. Ne rast se AK/njësia kërkuese pretendon se çmimet e tregut kanë ndryshuar ka mund të zvogëloj buxhetin e planifikuar për këtë projekt. Duke marr parasysh se ky aktivitet i prokurimit është planifikuar furnizim i përnjëhershëm dhe jo kontrate kornize apo procedure me peshim të çmimeve për njësi, raste kur OE do të mund të bënin kalkulime në pozicione të caktuara dhe mund të vie në shprehje kalkulimi i OE dhe manipulimi me çmime për pozicione të caktuara prandaj analiza të cilën ka bërë AK/komisioni vlerësues për pozicione veq e veq nuk mund të jetë e saktë. Autoriteti kontraktues me 24.04.2023, ka dërguar kërkesë për sqarime shtese ndaj kompanisë sonë për

pozicione të caktuara dhe sqarime/përgjigje tek AK kemi dërguar me 27.04.2023, po ashtu bashkangjitur me deklarate kemi dërguar faturat blerëse për të faktuar prejardhjen, kalkulimin e çmimit për secilin pozicion dhe në bazë të tyre konstatojmë se marzha e fitimit bruto për produktet e ofertuara është 15-30%.

Përgjigje në pretendim:

Pas analizimit të njoftimit për kontratë dhe FDT të publikuara në platformen elektronike e-prokurimi dhe dokumenteve të prezantuara nga OE ankues, AK ne raportin e vlerësimit të tenderëve dhe njoftimin mbi vendimin e AK e ka cekur që OE i plotëson të gjitha kriteret e dosjes së tenderit dhe njoftimit për kontratë mirëpo në listën e çmimeve për artikujt nr.3,4,5,16,19,20,23 dhe 24 ka dhënë çmime për njësi më të larta se çmimet e tregut/vlerës së parashikuar për artikuj nga njësia e kërkesës. Ekspertja shqyrtuese sqaron se lidhur më arsyen e eliminimit të OE, AK para inicimit të këtij aktiviteti të prokurimit duhej të vepronte në pajtim me nenin 13 paragrafi 13.1 i Rregullores nr.001/2022 për prokurim publik në të cilin thuhet se: Vlera e parashikuar e një kontrate publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar. Në parashikimin e vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim. Po ashtu këtë çështje e sqaron dhe nenin 16 paragrafi 1 i LPP-së i cili thotë se:

Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Çmimi i parashikuar i produkteve, shërbimeve dhe objekteve është çmimi i parashikuar i tyre në ditën e dërgimit të njoftimit të kontratës lidhur me to. Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për furnizim, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për produktet, shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifat e tjera.

Prandaj duke u bazuar në njoftimin për kontratë dhe FDT e publikuar nga AK për këtë aktivitet të prokurimit për të cilin AK ka parashikuar vlerën e kontratës 11,616.95€ në kohëzgjatje prej 20 ditëve si dhe kriter të dhënies çmimi më i ulët, ndërsa oferta e OE ankues është në vlerë prej 10,958.50€, vlerë e cila është me e ulët se vlera e parashikuar nga AK për këtë AP dhe pasi sipas raportit të komisioni të vlerësimit dhe njoftimit mbi vendimin e AK ky OE i plotëson të gjitha kriteret e njoftimit për kontratë dhe FDT, atëherë ky pretendim i OE ankues është i bazuar.

Ekspertja shqyrtuese konsideron se lënda duhet të kthehet në ri-vlerësim dhe të veprohet sipas kritereve të njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit si dhe konform legjislacionit në fuqi për prokurim publik.

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankues "Europrint Group" sh.pk

Pretendimi 1:

OE pretendon që është eleminuar pa të drejtë nga AK lidhur me çmimin për artikujt nr.4, 14 dhe 20. AK nuk ka pasur asnjë bazë ligjore që të na eliminoj nga aktiviteti i prokurimit, ta beje Anulimin e këtij aktiviteti të prokurimit dhe të na refuzoje Kërkesën për Rishqyrtim. Nëse nisëm nga kjo logjike skandaloze e Zyrtareve të AK-Policisë se Kosovës, që çdo herë kur kemi çmime për njësi të artikujve në ofertat e OE me të larta së çmimet për njësi të artikujve të planifikuara nga Njësia e Kërkesës, pa marre parasysh që kontrata është Kontrate Publike për një furnizim dhe vlera totale e ofertave te OE është me e lire se vlera e parashikuar e AK, atëherë çdo aktivitet i prokurimit që zhvillohet në Kosove, duhet të anulohet. Si ka mundësi që OE të ofertojnë vetëm me çmimet për njësi të artikujve të cilët AK – Njësia e Kërkesës i ka planifikuar, sidomos kur AK-Njësite e Kërkesës nuk bëjnë asnjë hulumtim të tregut por bazohen vetëm ne çmimet për njësi të kontratave të tyre paraprake, siç është rasti tani me AK-Policinë e Kosovës.

Përgjigje në pretendimin 1:

Duke u bazuar në kriteret e njoftimit për kontratë dhe FDT e publikuara për këtë aktivitet të prokurimit, AK për këtë aktivitet të prokurimit ka parashikuar Afatin kohorë për përfundim 20 ditë nga dhënia e kontratës me vlerë të parashikuar 11,616.95€ dhe si kriter të dhënies çmimi më i ulët. Pra AK në këtë AP nuk e ka cekur që si kriter i vlerësimit janë çmimet për njësi. Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK është i obliguar që para inicimit të një aktiviteti të prokurimit të veproj sipas nenit 13 paragrafi 13.1 i Rregullores nr.001/2022 për prokurim publik: 13.1 Vlera e parashikuar e një kontratë publike duhet të parallogaritet para inicimit të procedurës së prokurimit. Parallogaritja e tillë duhet të jetë e arsyeshme dhe reale për kontratën e parashikuar.

Në parashikimin vlerës së kontratës AK është përgjegjës për krahasimin e çmimeve të tregut, çmimeve të kontratave paraprake kur ato ekzistojnë, etj, me analizë të kostos të specifikimeve relevante teknike të mallrave, shërbimeve ose punëve për prokurim. Po ashtu AK lidhur më këtë AP duhet të veproj edhe në pajtim me nenin 16 paragrafi 1 i LPP-së: Vlera e parashikuar e kontratës së propozuar për furnizim duhet të jetë e barabartë me çmimin përfundimtar që duhet të paguhet nga autoriteti kontraktues për të gjitha produktet, shërbimet dhe objektet e tjera që përfshihen në një kontratë të tillë. Çmimi i parashikuar i produkteve, shërbimeve dhe objekteve është çmimi i parashikuar i tyre në ditën e dërgimit të njoftimit të kontratës lidhur me to.

Gjatë përcaktimit të vlerës së parashikuar të një kontrate të propozuar për furnizim, autoriteti kontraktues do t'i përfshijë të gjitha elementet e çmimit përfundimtar që mund të parashikohen në mënyrë të arsyeshme, që do të paguhet nga autoriteti kontraktues për produktet, shërbimet dhe lëndët e tilla, duke përfshirë çfarëdo dhe të gjitha taksat, doganat dhe tarifat e tjera.

Ekspertja shqyrtuese sqaron se bazuar në raportin e vlersimit të tenderëve dhe njoftimit mbi vendimin e AK me anën e të cilëve OE ankues e klasifikojnë si OE i cili i ka plotësuar të gjitha

kriteret e njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit por vetem për artikujt nr. 4, 14, 20 kanë dhënë çmime më të larta se çmimet e tregut, dhe duke marr parasysh kriteret e publikuara në njoftimin për kontratë dhe FDT nga AK në të cilat nuk është cekur që kriter i vlersimit janë çmimet për njesi, si dhe pas analizimit të ofertës financiare të OE ankues i cili ka ofertuar me çmim total 9,661.75€ vlerë e cila është më e ulët se vlera e parashikuar për kontratë, pretendimi i OE ankues është i bazuar.

Pretendimi 2: Sipas OE ankues AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka bërë shkelje të nenit 1, nenit 6, nenit 7 dhe nenit 59 të LPP-së.

Përgjigje në pretendimin 2:

Ekspertja shqyrtuese sqaron se AK është i obliguar që gjatë zhvillimit të të gjitha aktiviteteve të prokurimit të respektoj legjislacionin në fuqi të prokurimit publik, AK është i obliguar që fondet publike ti përdor në mënyrën më të drejtë, transparente dhe në mënyrë ekonomike. Sa i përket nenit 7 të LPP-së, AK nuk ka bërë shkelje të këtij neni pasi të gjithë OE të cilët kanë ofertuar në këtë AP i ka trajtuar njëjtë dhe nga të gjithë ka kërkuar sqarim për çmimet e artikujve të caktuar. Ndërsa lidhur me neni 59 të LPP-së AK është i obliguar që ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve ta bëj konform këtij neni.

Ekspertja shqyrtuese konsideron se lënda duhet të kthehet në ri-vlerësim dhe të veprohet sipas kritereve të njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit si dhe konform legjislacionit në fuqi për prokurim publik.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesat e OE-ve ankuese të aprovohen si e bazuara, të anulohet njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi, e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli dhe si rrjedhojë paneli vendosi që ankesat OE-ve, ankuese "Infinitt" sh.p.k, dhe "Europrint Group" sh.p.k, të aprovohen si të bazuara dhe të anulohet B58 Njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues i datës 04.05.2023, ndërkaq aktiviteti i prokurimit me të dhënat si më sipër kthehet në rivlerësim.

-Përfundim-

Paneli shqyrtues konstaton se bazuar në të gjeturat në ketë aktivitet të prokurimit si dhe mbështetur në raportin e ekspertit shqyrtues, ky aktivitet i prokurimit të kthehet në ri-vlerësim dhe të veprohet sipas kritereve të njoftimit për kontratë dhe dosjes se tenderit si dhe konform legjislacionit në fuqi për prokurim publik.

Paneli Shqyrtues kërkon nga AK që të njëjtit të jenë të vëmendshëm gjatë procedurave të prokurimit publik në të ardhmen duke respektuar në përpikëri Ligjin e Prokurimit Publik dhe rregullat e zbatueshme, dhe po ashtu urdhëron të njëjtit të veprojnë në harmoni me rekomandimet e dhëna në këtë vendim, në të kundërtën Organi Shqyrtues i Prokurimit nga kuadri i Paneleve Shqyrtuese, ka të drejtë të kërkoj ndërmarrjen e masave disiplinore ndaj zyrtarëve përgjegjës të prokurimit.

Paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:
Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkalles se pare, Departamentit Administrativ në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Kryetarja e Panelit Shqyrtues

Kimete GASHI

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK-së- Policia e Kosoves
1x1 OE ankues-" Infinitt" Sh.P.K.dhe OE "Europrint Group" Sh.P.K,
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.